NR. 37, MARS 2025 | Viti IV

Revistë e përmuajshme (politike-diplomatike)

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



# "PANEM ET CIRCENSES"

## Bukë dhe Cirk

- Zgjidhet Kryepeshkopi i ri i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare

- Si Trump po përmbush vizionin strategjik të Macron për Evropën

- Mosmarrëveshje transatlantike në Ballkan?

## Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.
Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.
Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.
**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpuntorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.
Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**"Argumentum", një proces intelektual ...**

**Marjana DODA**
**Kryeredaktore**

# Përmbajtja


**03 EDITORIAL**
- "Panem et circenses" (Bukë dhe cirk).

**05 FOKUS**
- Muzeu mobil "Luftërat e Çanakalasë", manipulim historik dhe propagandë në Ballkan.
- Joan Pelushi zgjidhet Kryepeshkopi i ri i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare

**09 OP/ED**
- Si Trump po përmbush vizionin strategjik të Macron për Evropën- ***Nga Marjana DODA***
- Ditë të paparashikueshme përpara- ***Nga Dr. J. Scott Younger***
- Mosmarrëveshje transatlantike në Ballkan?- ***Nga Frauke Seebass***

**17 REALPOLITIK**
- Europa riarmatoset! Gjermania bën epokë! Hallvë e ftohtë! Komisionerja Kos kërkon reforma!

**19 JO VETEM LAJM**
- A po formohet një aleancë ushtarake në Ballkan?
- Shqipëria shënon 16-vjetorin e anëtarësimit në NATO.
- Urdhëri ekzekutiv nga Trump: Mbyllet Zëri i Amerikës dhe Radio Evropa e Lirë.

***ENGLISH EDITION***

**24 REALPOLITIK**
- Europe riarmed! Germany's epochal shift! Spoiled soup! EU Commissioner Kos demands reforms!

**26 IN FOCUS**
-Serbia's Protests Are a Call Against Kleptocracy – The EU Must Seize the Opportunity.

**28 BALKAN OVERVIEW**
- Recognition of the Republic of Kosovo by Kenya, an Important Moment.

**29 GLOBAL**
- Securing Tomorrow: How Greenland Fits into Trump's Strategic Vision for American Dominance.

# "Panem et circenses"




Lulzim Basha, tani në cilësinë e kreut të partisë së tij të re "Demokratët Euroatlantikë", po zhvillon një "betejë" të ashpër me kryeministrin aktual dhe kreun e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Edi Rama. Një lojë fjalësh "qesh e ngjesh", siç thonë shqiptarët, që duket të jetë aq e koordinuar sa të krijon përshtypjen se ata mund të kenë rënë dakord për këtë komunikim online. Sigurisht kjo dakordësi nuk është e re për dy liderët, pasi marrëveshja e 17 majit 2017 është ende e freskët për politikën shqiptare dhe për popullin shqiptar.

Gjithsesi, duhet theksuar se ky lloj komunikimi është atipik për Lulzim Bashën, por jo aq për Edi Ramën, i cili ka arritur të bëhet një ekspert i komunikimit digjital. Rama jo vetëm që ka krijuar një podcast të tij, ku zhvillon propagandën e tij me individë të suksesshëm që i seleksionon dhe i përdor për t'i promovuar në arenën politike, por gjithashtu, përpara zgjedhjeve parlamentare, ai ka zgjedhur sërish të përdorë kanalet e komunikimit online, duke ndërvepruar drejtpërdrejt me qytetarët përmes komenteve në rrjetet sociale, gjithmonë nën sloganin "Sy me sy". Nga ana tjetër, Basha është më i tërhequr ndaj kësaj forme komunikimi dhe preferon të flasë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa përdorur ironi apo batuta ndaj elektoratit ose qytetarëve.

Mënyra si papritur Lulzim Basha i dërgoi një video-mesazh kryeministrit Rama në dialekt, duke e thirrur "O Rame", u pa me habi. Në fakt, kjo gjuhë nuk i shkon aspak Lulzim Bashës, i cili, edhe pse më i ri në moshë se z. Rama, ka karakterin e tij politik dhe personal serioz. Por gjithsesi kjo nuk përbën problem, ajo që ngre pikëpyetje në këtë formë të re komunikimi nga Basha është se çfarë e shtyu ta përdorë këtë gjuhë dhe këtë format në platformat online, kryetarin e partisë "Demokratët Euroatlantikë", ku për herë të parë do e provoje veten para zgjedhësve, më 11 maj 2025.

Në fakt, pas rikthimit të Sali Berishës dhe Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka qenë gati i padukshëm në diskursin e tij politik. Edhe themelimi i partisë së tij të re nuk pati ndonjë impakt të dukshëm; ai ende shihet me skepticizëm, pasi nuk ka arritur të krijojë një elektorat të tij. Deri tani, Basha ka qëndruar në hijen e Partisë Demokratike, partisë më të madhe opozitare, që sot është ende nën drejtimin z. Sali Berisha. Kështu e ka pohuar edhe vetë Basha, duke justifikuar disa herë veprimet apo mosveprimet e tij gjatë periudhës kur ishte pjesë e asaj partie. Sigurisht, vendimi i tij për ta përjash-

tuar Berishën nga Partia Demokratike iu kthye si një bumerang politik, pasi, ndërkohë që mori kredibilitet përballë faktorit ndërkombëtar, ai u izolua plotësisht nga vete demokratët.
Në këtë situatë, ku ndodhemi më pak se dy muaj para zgjedhjeve parlamentare, ku partia e Lulzim Bashës dhe ai vetë si kreu i saj do të testohen përballë qytetarëve shqiptarë, kjo formë komunikimi që ai përdori ndaj kryeministrit Rama duket thjesht një demagogji marketingu politik. Duke ditur se Basha dhe partia e tij janë ende në fazën e konsolidimit dhe duke pasur parasysh skepticizmin e vazhdueshëm ndaj tij, kjo lëvizje nuk paraqet një ndryshim të vërtetë, por më shumë një përpjekje për të krijuar një imazh në media dhe për të tërhequr vëmendjen e elektoratit. Pra më shumë një manovër taktike për të fituar pikë, se sa një hap autentik në komunikimin politik qe i sherben realisht shqiptarëve.
Nga ana tjetër, kjo situatë i shërben plotësisht strategut të piarit, Kryeministrit Rama. Duket se ai ka zgjedhur me kujdes kundërshtarin politik, pra partinë opozitare që do të ketë përballë në këto zgjedhje, por edhe në Parlamentin e Shqipërisë. Madje Rama po ndërton vetë një opozitë të re, pra në këtë rast partinë e Bashës, e cila është e dobët dhe pa një bazë solide mbështetjeje, duke forcuar kështu pozitat e tij në skenën politike.
Kjo duket të jetë marrëveshja e dytë mes Kryeministrit Rama dhe Bashës, pas marrëveshjes së 17 majit, që riktheu Partinë Demokratike në Parlament, pas një periudhe bllokimi, ku Basha dhe opozita ishin ngujuar në çadrën përpara Kryeministrisë për tre muaj. "Çadra e Lirisë" u shpërbë pas marrëveshjes së orëve të vona, e cila padiskutim ndihmoi Kryeministrin Rama të fitonte mandatin e dytë si Kryeministër në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017. Më vonë, pati akuza të shumta, duke aluduar se ekzistonte një marrëveshje tjetër përveç asaj që u paraqit në publik mes Bashës dhe Ramës në Kuvendin e Shqipërisë, e cila kishte si synim përçarjen e plotë të Partisë Demokratike.
Në kete rast, nëse nuk është një marrëveshje e drejtpërdrejtë, ky komunikim virtual është padyshim një dakordësi mes Ramës dhe Bashës, ku të dy përfitojnë. Nëse Lulzim Basha ka qëllim të tërheqë vëmendjen dhe të dërgojë mesazhe elektoratit, duke treguar se po përdor të njëjtën gjuhë dhe stil komunikimi që përdor Kryeministri Rama. Nga ana tjetër, Kryeministri Rama po tenton të rikthje sërish Bashën si lider opozitar, duke shmangur përballjen e drejtpërdrejtë me partitë e tjera opozitare, qoftë ato të vjetra, apo ato të reja. Në veçanti Partinë Demokratike, e cila së bashku me partitë e tjera të koalicionit "Shqipëria Madhështore", tani nën drejtimin e z. Berisha, është në objektivin e Ramës për ta minimizuar, ndërsa për partitë e reja, Rama synon t'i mbajë ato nën kontroll pas zgjedhjeve të 11 majit, veçanërisht nëse do të ketë nevojë për një koalicion qeveritar.
Pra, z. Basha vazhdon të përdoret për të tërhequr vëmendjen dhe për të larguar fokusin nga Berisha, duke treguar se kjo "lojë" virtuale mes Ramës dhe Bashës është thjesht një manovër politike, e cila zhvillohet në kurriz të qytetarëve.
Asgjë e re për qytetarin shqiptar që pret më shumë zgjidhje për një jetë më të mirë, për siguri, drejtësi, për nivel më të lartë arsimor dhe shëndetësor, si dhe për mirëqenie. Asnjë nga këto nuk iu ofrohet qytetarëve, të cilëve iu kërkohet të votojnë. Për momentin, Rama dhe Basha kanë në agjendë këtë maskaradë virtuale për të krijuar një shfaqje politike, e cila ka marrë formën e një telenovele turke.
Një cirk mediatik që ia hedhin turmës, me shkelje syri, qeshje e nënqeshje, me hip-hop, timon e tigan, të gjitha të sintonizuara me njëra-tjetrën.
Kjo na kujton një thënie të vjetër, por që sot merr kuptim më shumë se kurrë;"Panem et circenses" – "Bukë dhe cirk".
Një shprehje që simbolizon praktikën e perandorëve romakë, të cilët e përdornin si një strategji për të mbajtur popullin nën kontroll dhe të kënaqur. Një mjet për të shmangur pakënaqësinë dhe revoltat, duke i larguar qytetarët nga realiteti i vështirë dhe padrejtësitë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Shqipërinë e sotme, ku, prej ditësh, cirku politik i dy palëve, Rama dhe Basha, është i pranishëm në çdo rrjet social, media online dhe media vizive. Të dy palët ofrojnë një shfaqje spektakolare për popullin, duke e mbajtur atë të angazhuar në një lojë politike që i largon nga realiteti i vërtetë dhe kërkesat për një jetë më të mirë.
Kjo demagogji e vjetër që vazhdon të dominojë skenën politike, është një shenjë e dëshpërimit për shoqërinë shqiptare. Populli, i lodhur dhe i zhgënjyer, nuk po kërkon më ndryshim të vërtetë. Nuk po proteston, nuk po kërkon llogari, por ka rënë në një gjendje pasiviteti, duke u argëtuar dhe komentuar në rrjetet sociale, duke u bërë kështu pjesë e një cirku mediatiko-politik që i shërben vetëm interesave të ngushta të pushtetit.
E megjithatë, nëse perandorët romakë, të paktën, ofronin "bukë dhe cirk", kjo klasë politike ofron vetëm cirk…

# MUZEU MOBIL "LUFTËRAT E ÇANAKALASË"
## manipulim historik dhe propagandë në Ballkan

Pesë shekuj të ndikimit të otomanizmit në Ballkan, e sidomos në trevat shqiptare, janë një njollë e errët e trashëgimisë së Perandorisë Osmane. Një fakt historik, të cilën Turqia moderne mundohet ta manipuloje në çdo moment, duke përdorur mjetet e saj të propagandës. Për këtë arsye, janë bërë disa tentativa konkrete për të ndryshuar perceptimin e këtij fakti historik, qofshin këto nëpërmjet kurrikulave shkollore apo dhe në diskursin publik. Për hir të interesave aktuale dhe marrëdhënieve të sotme, duket se shumë herë është injoruar ose harruar ajo që ka ndodhur gjatë kësaj periudhe të gjatë historike. Padiskutim e shkuara nuk mund të jetë pengesë për të tashmen dhe të ardhmen, për sa kohë ajo pranohet si fakt historik, pa u shtrembëruar. Kjo, megjithatë, nuk po ndodh me qasjen e Turqisë ndaj Osmanizmit dhe shqiptarëve në veçanti. Megjithatë, ky është një fakt që kërkon të studiohet me kujdes, sidomos nga akademikët dhe studiuesit në Shqipëri dhe Ballkan.

Ajo që vihet re, është se vitet e fundit ka një ndikim të madh të Turqisë në Ballkan, në formën e një "fuqie të butë," ku pushtimi 500-vjeçar i Perandorisë Osmane po paraqitet si një periudhë "vëllazërie" mes shqiptarëve dhe turqve.

Një shembull i fundit është muzeu mobil i betejës së Çanakalasë, një nga betejat më të rëndësishme për Turqinë e asaj kohe dhe për Turqinë e sotme, ku morën pjesë mijëra shqiptarë nga të gjitha trevat shqiptare.

Me moton "Ku valon flamuri i kuq, aty është Çanakale", muzeu ynë mobil, i cili ka udhëtuar në të gjitha cepat e Turqisë, tani po shkon drejt zemrës sonë, Ballkanit", është njoftimi i muzeut mobil.

Kosova ishte ndalesa e parë në Ballkan për muzeun mobil, me të cilin Turqia po tregon historinë e saj për Betejën e Çanakalasë në kuadër të 110-vjetorit të asaj që njihet edhe si Beteja e Galipolit, midis forcave britanike dhe franceze nga njëra anë dhe ushtrisë osmane, të ndihmuar nga Austro-Hungaria dhe Gjermania, nga ana tjetër.

Pas Kosovës, aktualisht muzeu mobil ndodhet në Shqipëri deri më 28 Mars. Më pas udhëtimin e tij historik do ta vijoje në Mal





të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Maqedoninë e Veriut për të përfunduar këtë udhëtim në Bullgari në maj.

Lufta e Çanakalasë, e njohur edhe si Beteja e Dardaneleve, ishte një betejë e rëndësishme që ndodhi gjatë Luftës së Parë Botërore, midis vitit 1915 dhe 1916, dhe ishte një moment kyç në përpjekjet e aleatëve për të hapur një front të dytë kundër Perandorisë Osmane. Kjo betejë ndodhi në rajonin e Dardaneleve, një ngushticë që lidh Detin Egje me Detin Marmara dhe ka pasur një rëndësi strategjike të jashtëzakonshme për kontrollin e rrugëve detare të Lindjes së Mesme dhe Azisë.

Në betejen e Canakalasë mendohet se aty kanë humbur jetën rreth 280 mijë persona, ndër të cilët 25 mijë shqiptarë. Ishte një nga betejat më të mëdha në Luftën e Parë Botërore ku forcat osmane fituan dhe Turqia feston lavdinë e saj.

Mijëra shqiptarë nga treva të ndryshme morën pjesë në betejën e Çanakalasë, dhe shpesh herë Turqia e ka përdorur këtë ngjarje si një trashëgimi të përbashkët vëllazërore.

## Roli i shqiptarëve në luftën e Çanakalasë dhe përpjekjet e Turqisë për të manipuluar historiografinë

Pjesëmarrja e shqiptarëve në këtë betejë ka ngjallur pikëpyetje historike ndër dekada.

Turqia është përpjekur të ndryshojë ose të retushoje historiografinë në mënyra që shpesh e paraqesin Perandorinë Osmane në një dritë më pozitive për shqiptarët.

Kjo përpjekje është e lidhur me përpjekjet për të promovuar një identitet turk dhe osman të përbashkët, për të nënvizuar se shqiptarët ishin "vëllezër" që kishin ndihmuar Turqinë në betejat e ndryshme, përfshirë betejen e Çanakalasë.

Kjo strategji është gjithashtu një mënyrë për të pasuruar narrativën e kombit turk dhe për të krijuar një lidhje historike dhe emocionale me popujt e ish-perandorisë, duke theksuar ndihmën që shqiptarët dhanë për mbrojtjen e Perandorisë Osmane, pavarësisht realiteteve të vështira të periudhës osmane për popullin shqiptar.

Sipas Turqisë, edhe pse shqip-

> *Turqia është përpjekur të ndryshojë ose të retushoje historiografinë në mënyra që shpesh e paraqesin Perandorinë Osmane në një dritë më pozitive për shqiptarët. Kjo përpjekje është e lidhur me përpjekjet për të promovuar një identitet turk dhe osman të përbashkët, për të nënvizuar se shqiptarët ishin "vëllezër" që kishin ndihmuar Turqinë në betejat e ndryshme, përfshirë betejen e Çanakalasë.*

tarët sapo kishin dalë nga pushtimi osman, ata luftuan për kombin turk. Nuk ka dyshim se mijëra shqiptarë morën pjesë në betejën e Çanakalasë, por është e pabesueshme që ata e bënë këtë me vullnet të plotë. Shumë prej tyre ishin robër, dhe pjesa tjetër u detyruan të merrnin pjesë në atë luftë, për shkak të kushteve dhe presionit të Perandorisë Osmane.

Një nga argumentet kryesore pse shqiptarët, sidomos ata që ishin ende nën ndikimin ose kontrollin e Perandorisë Osmane, mund të ishin të detyruar të merrnin pjesë në Betejën e Çanakalasë ka të bëjë me strukturat hierarkike dhe detyrimet e shërbimit ushtarak që ishin të lidhura ngushtë me statusin dhe pozitën që ata kishin brenda Perandorisë Osmane.

Faktet historike nuk mund të retushohen, pavarësisht interesave të ngushta politike; ato janë pjesë e historisë, dëshmi e një periudhe të caktuar për të cilën nuk mund të fajësohen pasardhësit politikë. Megjithatë, pikërisht këtë histori, ndonëse jo në favor të saj, Turqia e përdor si dëshmi të ndikimit dhe pushtetit të saj në Ballkan. Beteja e Çanakalasë është një dëshmi dhe një e vërtetë historike për Turqinë, por kjo nuk tregon të vërtetën e pjesëmarrjes së mijëra shqiptarëve, të cilët u përdorën si mish për top në atë betejë gjakatare.

Megjithatë, sikundër e theksuam në fillim të këtij artikulli, historianët do të duhej ta kishin zbardhur këtë fakt historik, jo për shkak se shqiptarët morën pjesë në atë betejë dhe luftuan krah Turqisë, por për faktin se Perandoria Osmane ka qenë pushtuese e këtyre trojeve dhe shqiptarët ishin të detyruar të merrnin pjesë në atë kohë. Përpos kësaj, ajo që ka rëndësi të theksojmë është vijimi i agjendës së politikës së jashtme të Turqisë ndaj Ballkanit në përgjithësi dhe trojeve shqiptare në veçanti.

*Ky muze, në fakt, nuk është për të na treguar të djeshmen, por na paralajmëron për të sotmen dhe të ardhmen. Sot, si kurrë më parë, retorika e Luftës së Tretë Botërore është kthyer në tryezat aspak diplomatike të udhëheqësve botërorë. Nisur pra dhe nga konteksti gjeopolitik, ku po përballemi me formimin e aleancave të reja, secili po përdor mënyrat e tij për t'u përgatitur për të panjohurat që na sjellin konjukturat gjeopolitike përpara nesh.*



Ndaj muzeu mobil "Luftërat e Çanakalasë" nuk është vetëm një mjet për të na përkujtuar të kaluarën, por edhe një përpjekje për të formësuar të tashmen dhe të ardhmen, duke shpërndarë një mesazh të fuqishëm për popujt e Ballkanit dhe më gjerë.

Muzeu mobil "Luftërat e Çanakalasë" vjen në trojet shqiptare si dëshmi e ndikimit turk, duke tentuar të shesë një histori të lavdishme sipas narratives se shqiptarët u hodhën në luftë për të mbrojtur Turqinë. Në fakt, historia ishte ndryshe në atë kohë, e cila e shpjegojmë më lart. Ajo që të bën përshtypje është konteksti historik i kësaj ngjarjeje. Nëse 110 vjet më parë kjo do të shënohej si një nga fitorët më të rëndësishme të Turqisë gjatë Luftës së Parë Botërore, duket se jehona e luftës është rikthyer sërish. Ky muze, në fakt, nuk është për të na treguar të djeshmen, por na paralajmëron për të sotmen dhe të ardhmen. Sot, si kurrë më parë, retorika e Luftës së Tretë Botërore është kthyer në tryezat aspak diplomatike të udhëheqësve botërorë. Nisur pra dhe nga konteksti gjeopolitik, ku po përballemi me formimin e aleancave të reja, secili po përdor mënyrat e tij për t'u përgatitur për të panjohurat që na sjellin konjukturat gjeopolitike përpara nesh. Prandaj, mund të themi se Turqia po e bën këtë tur ballkanik edhe si një formë propagande që Erdogan përdor për të mbajtur rreth vetes shqiptarët dhe jo vetëm, praktikisht të gjitha vendet ku ky muze mobil do të udhëtojë për të treguar ndikimin dhe influencën e Turqisë në Ballkan, gjithmonë në emër të "historisë".

# Joan Pelushi zgjidhet Kryepeshkopi i ri i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare

Hirësi Joan Pelushi u zgjodh sot Kryepeshkopi i ri i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Zgjedhja e Kryepeshkopit Joan u bë nga Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse, pas Liturgjisë Hyjnore të së dielës, që për besimtarët ortodoksë përkon me të dielën e dytë të Kreshmës.

Hirësi Joani u prit me një ceremoni të veçantë dhe hyri në Katedralen "Ngjalla e Krishtit", ndërsa kambanat e saj dhe ato të të gjitha kishave ortodokse në Shqipëri, ranë njëkohësisht në nder të këtij momenti historik.



Pas shpalljes së emrit të tij, Kryepeshkopi i ri mbajti një fjalë të shkurtër, që u prit nga dhjetëra besimtarë të pranishëm me duartrokitje dhe thirrjet "i denjë".

"Me përulësi, duke iu bindur vullnetit hyjnor, pranoj këtë shërbim të lartë dhe premtoj se do ta zbatoj me devotshmëri detyrën time. Do respektoj traditën e shenjtë dhe do përpiqem me forcë të mbroj të drejtat e Kishës. I vetëdijshëm për peshën e kësaj përgjegjësie, i lutem Krishtit të më japë ndriçim, forcë dhe urtësi për të përmbushur këtë mision. Me dorën time e nënshkruaj këtë zotim," u shpreh Imzot Joani.

Joan Pelushi ka studiuar për disa vite në shkollën teologjike ortodokse të Kryqit të Shenjtë pranë Bostonit në Shtetet e Bashkuara.

Ai është diplomuar nga Fakulteti Ortodoks i Teologjisë Kryqi i Nderuar në Amerikë (Holy Cross Orthodox School of Theology, Boston), me gradën "Master of Divinity".

Ka studiuar në SHBA falë një burse studimi të themeluar atje nga shqiptarët në Amerikë në kujtim të Fan Nolit.

Ai ka shërbyer më parë si pedagog dhe dekan i Akademisë Teologjike të Kishës Ortodokse Shqiptare.

Ai do të pasojë në këtë detyrë të lartë Kryepeshkopin Anastas Janullatos, i cili u nda nga jeta në moshën 95-vjeçare më 25 janar 2025 në një spital në Athinë.

Në testamentin e tij, Kryepeshkopi Anastas shprehu dëshirën që Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë të ketë në krye një klerik shqiptar.

Kisha Autoqefale Shqiptare njoftoi më pas se mes shumë urimesh, edhe Bartholomeu i Konstandinopojës ka uruar Joan Pelushin i cili është zgjedhur sot Kryepeshkop i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë.

Ai i ka uruar atij shërbim të gjatë.

"Patriarku ekumenik uron kryepeshkopin e Shqipërisë. Fortlumturisë së tij, Kryepeshkopin e Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë, Joan. Fortlumturi vëlla i shenjtë. Sapo morëm në Fanar lajmin e zgjedhjes Tuaj të denjë në Fronin Kryepiskopal të Shqipërisë, nxitojmë t'ju përgëzojmë nga zemra dhe në pritje të Letrave Tuaja të Nderuara Paqësore, qëndrojmë me shumë respekt dhe dashuri në Zotin, duke ju uruar një shërbim të gjatë dhe të shkëlqyer Kryepriftëror! I denjë! Vëllazërisht, Bartholomeu i Konstandinopojës", thuhet në njoftimin e Kishës Ortodokse.

# Si Trump po përmbush vizionin strategjik të Macron për Evropën





Nga Marjana DODA

Emmanuel Macron u zgjodh president i Francës në maj të vitit 2017 në moshën 39-vjeçare, duke e bërë atë presidentin më të ri në historinë e vendit dhe kreun më të ri të shtetit francez që nga Napoleon Bonaparti.

Nuk mund të themi se Emmanuel Macron ka ngjashmëri me Napoleonin si udhëheqes dhe strateg por një aspekt që mund të jetë i ngjashëm është aspirata e tij për të rivendosur një pozicion të fuqishëm për Francën në arenën ndërkombëtare dhe për të forcuar rolin e saj si një shtyllë kryesore e Europës.

Emmanuel Macron erdhi me një vizion të ri dhe ambicioz për të konsoliduar rolin e Francës në nivelin ndërkombëtar, si dhe një vizion të thellë për një Europë të fuqishme dhe të bashkuar.

Një nga qëndrimet e tij kryesore ishte se Bashkimi Evropian (BE) kishte humbur objektivin e tij dhe duhej të reformohej për të përballuar sfidat e reja të botës moderne. Macron argumentoi se BE kishte nevojë për një "rilindje" dhe për një strategji të re për të qenë më të fuqishëm dhe më të lidhur me qytetarët e tij. Ai vuri në dukje se, ndërsa Bashkimi Evropian kishte qenë një projekt i suksesshëm për ruajtjen e paqes dhe prosperitetit pas Luftës së Dytë Botërore, kishte filluar të humbiste drejtimin dhe qëllimet e tij në kontekstin e sfidave të sotme.

Emmanuel Macron ka qenë gjithashtu një nga liderët evropianë të parë që ka folur dhe promovuar idenë e krijimit të një ushtrie të pavarur evropiane. Në vitin 2018, Macron propozoi krijimin e një "ushtrie evropiane" si një mundësi për të mbrojtur më mirë interesat e Evropës në një botë gjithnjë e më të pasigurt, dhe për të siguruar që Evropa të ketë

më shumë ndikim dhe kapacitete për të mbrojtur veten pa pasur nevojë për mbështetje të jashtme, sidomos nga Shtetet e Bashkuara. Mbi të gjitha, Macron theksonte në çdo rast se Evropa duhet të luante një rol më të madh në botë dhe të përgatitej për sfida të reja globale.

Megjithëse angazhimet e tij publike janë hasur në kundërshtime nga aleatët, brenda dhe jashtë Evropës, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Macron ka vazhduar me ambiciet e tij për të forcuar rolin e Francës si në Evropë ashtu edhe në nivel global. Nëse analizojmë angazhimet e tij në politikën e jashtme, mund të shohim se ai ka punuar gjatë gjithë kohës për tu përballuar sot me sfidat e reja gjeopolitike, ende me situata të panjohura, por që padyshim Bota nuk do të jetë ajo që kemi njohur që nga fundi i Luftës së Ftohtë.

Kështu, gjatë 7 viteve të presidencës së tij, Macron fokusoi vëmendjen e tij në marrëdhëniet bilaterale dhe trilaterale me shtetet mike dhe aleate, duke nënshkruar marrëveshje, partneritete dhe traktate që kanë në qendër mbrojtjen.

## Macron dhe Trump: Përplasje dhe Përshtatje në Politikën e Jashtme

Donald Trump nuk e ka mbështetur vizionin e Emmanuel Macron për një Europë të fortë dhe të bashkuar.

Së pari Trump ka qenë kundër idesë për krijimin e një ushtrie të përbashkët europiane, duke argumentuar se kjo mund të dëmtonte marrëdhëniet e NATO-s dhe mund të çonte në përpjekje të panevojshme për të konkurruar me Shtetet e Bashkuara në fushën e mbrojtjes.

Së dyti Trump, ka pasur qëndrime të kundërta ndaj këtyre ideve. Ai ka qenë kritik ndaj Bashkimit Europian në përgjithësi dhe ka pasur një qasje më të fokusuar në interesat kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Trump ka sugjeruar se një Europë më e centralizuar mund të ishte një kërcënim për sovranitetin e shteteve individuale, duke pasur një qasje më të rezervuar ndaj ideve të integrimit të thelluar të BE-së.

*"Truri i NATO-s ka vdekur"*

Në një intervistë për "The Economist," në vitin 2019, Emmanuel Macron shprehu shqetësimin e tij për NATO-n, duke thënë se truri i saj po vdes dhe se Europa nuk mund të mbështetet më tek Amerika për sigurinë e saj. Ai paralajmëroi se, nëse Europa nuk vepron, mund të humbasë kontrollin mbi fatin e saj dhe të zhduket gjeopolitikisht.

"*Nëse nuk zgjohemi (Europa) ekziston një rrezik i konsiderueshëm që për një kohë të gjatë do të zhdukemi gjeopolitikisht, ose të paktën se nuk do të jemi më në kontrollin e fatit tonë. Unë e besoj shumë këtë. Ajo që ne po përjetojmë tani është vdekja e trurit të NATO-s. Evropa po qëndron në skajin e një gremine të thellë. Evropa nuk do të mund të kontrollojë më fatin e saj nëse nuk mendon një lëvizje strategjike për veten e saj*", theksoi ai.

Nga ana tjetër, Presidenti amerikan Donald Trump tha se SHBA-të nuk do të luftojnë për aleatët e NATO-s që nuk shpenzojnë mjaftueshëm për mbrojtjen e tyre. "Unë mendoj se është një sens i përbashkët", tha presidenti. "Ata nuk paguajnë, unë nuk do t'i mbroj ata".

Ai vazhdoi të akuzonte aleatët e NATO-s se nuk ishin të gatshëm të mbronin Shtetet e Bashkuara, nëse rolet do të ndryshonin.

"*Nëse Shtetet e Bashkuara ishin në telashe, dhe ne i telefononim, thoshim se kemi një problem, Franca, kemi një problem, disa të tjerë, nuk do t'i përmend – mendoni se ata do të vijnë të na mbrojnë? Ata duhet të bëjnë, nuk jam aq i sigurt*", shtoi shefi i Shtëpisë së Bardhë.

Në mënyrë të ngjashme, Trump ka kritikuar shumë herë NATO-n për atë që ai e ka konsideruar një aleancë të paaftë dhe të shtruar për SHBA, duke thënë se shumë shtete të tjera anëtare të NATO-s nuk po kontribuonin në mënyrë të mjaftueshme dhe po mbështeteshin në mbrojtjen e ofruar nga SHBA. Ai gjithashtu ka kritikuar mënyrën se si BE është menaxhuar dhe ka kërkuar që shtetet anëtare të bëjnë më shumë për të forcuar mbrojtjen e vet dhe të mos varen kaq shumë nga Uashingtoni.

Pra duket se vizioni i Macron për një Europë më të fortë dhe më të pavarur po përputhet me politikën proteksioniste të Donald Trump, "Amerika e Para".

Ndërsa Macron ka theksuar rëndësinë e një politike të pavarur të mbrojtjes për Evropën, Trump është shumë më i drejtpërdrejtë dhe më i ashpër në vlerësimet e tij, duke e bërë më të qartë se nuk ka asnjë hezitim të tërhiqet nga angazhimet ndërkombëtare nëse ato nuk shërbejnë interesave të SHBA-së.

Ndonëse të dy kritikojnë natyrën e njëanshme të politikave të NATO-s dhe marrëdhënieve të saj me SHBA-në, Macron e shpreh këtë më shumë në kuadër të një dialogu për forcimin e Evropës dhe autonomisë strategjike, ndërsa Trump thekson "Amerika e Para" dhe dëshirën për të ristrukturuar marrëdhëniet ndërkombëtare që i shërbejnë më shumë interesave të SHBA-së.

> "Nëse nuk zgjohemi (Europa) ekziston një rrezik i konsiderueshëm që për një kohë të gjatë do të zhdukemi gjeopolitikisht, ose të paktën se nuk do të jemi më në kontrollin e fatit tonë. Unë e besoj shumë këtë. Ajo që ne po përjetojmë tani është vdekja e trurit të NATO-s. Evropa po qëndron në skajin e një gremine të thellë. Evropa nuk do të mund të kontrollojë më fatin e saj nëse nuk mendon një lëvizje strategjike për veten e saj".

Gjithashtu fjalimi i zëvendëspresidentit amerikan në Konferencën e Sigurisë në Mynih e bëri të qartë se Shtetet e Bashkuara po distancohen nga përgjegjësitë globale, ose asaj që ka qenë e njohur si "polici i botës". Ky ndryshim po sjellë një tronditje në marrëdhëniet, marrëveshjet dhe ekuilibrat ekzistues, duke hapur mundësinë për krijimin e marrëveshjeve, aleancave dhe zëra të rinj.

Dhe këtu arrijmë tek ajo që ka sjellë në tryezën globale presidenti i Francës, që nga mandati i tij i parë si president i Francës: vizionin e tij për Europën.

Duke iu përgjigjur këtij qëndrimi të ri amerikan, pas fjalimit të zëvendëspresidentit amerikan në Konferencën e sigurisë në Mynih, si dhe pas përplasjes mes Trumpit dhe Zelensky në Shtëpinë e Bardhë, Macroni e riktheu në fokus vizionin e tij për Europën.

Fjalimi i fundit i Presidentit Macron, drejtuar jo vetëm kombit francez, por edhe Europës dhe botës, i dha një tjetër theks rëndësisë së politikave që ai ka promovuar që nga dita e parë që mori detyrën si president i Francës: forcimin e rolit të Europës në skenën ndërkombëtare, duke e bërë atë më të pavarur dhe më të aftë për të mbrojtur interesat e veta.

Një nga pikëpamjet kyçe që ai ka theksuar vazhdimisht është se Europa duhet të marrë përgjegjësinë për mbrojtjen e vet, duke u bërë më e fortë në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes. Macron ka mbështetur fuqishëm idenë e krijimit të një politikë të jashtme dhe të sigurisë më të pavarur për Europën, duke sugjeruar që kontinentit i nevojitet një mundësi më e madhe për të ndërmarrë veprime pa pasur gjithmonë nevojë për mbështetje të drejtpërdrejtë nga SHBA.

Një tjetër element që ai ka theksuar është rëndësia e forcimit të mbrojtjes bërthamore, duke siguruar që Europa të jetë në gjendje të mbrojë vetveten nga çdo kërcënim potencial.

Fjalimi i Macronit riktheu kërkesën për një Europë më të bashkuar dhe më të fortë, e cila ka kapacitetin për të mbrojtur interesat e veta dhe të luajë një rol udhëheqës në botën e globalizuar. Ai i bëri thirrje vendeve të Bashkimit Evropian të jenë të bashkuara dhe të qëndrojnë të forta përballë sfidave globale, duke pasur parasysh se koha për t'u bërë më të pavarur dhe më të fuqishëm ka ardhur.

Duket se Macron ka qenë i parakohshëm në deklaratat e tij, por ato nuk ishin të pavend. Ato sot i ngjajnë një profecie që po realizohet, veçanërisht për shkak të qasjes së re që SHBA-ja ka adoptuar në politikën e saj të jashtme. Kjo qasje e re, në një sfond të ri gjeopolitik, na rikthen te vizioni i Macron, madje një vizion që duket se po përmbushet, falë Trump.

Të gjitha këto aspekte që përmendëm më sipër si rinovimi i traktateve me vendet mike dhe aleate, marrëveshjet, vizitat zyrtare, janë në thelb shtyllat kryesore që Macron ka ndërtuar si pjesë e strategjisë së tij për t'u përgatitur për ndryshimet tektonike globale që janë duke u zhvilluar. Në këtë kontekst, Macron po zbaton vizionin e tij për të pozicionuar Francën si një aktor kyç, me një rol udhëheqës në Evropë dhe më gjerë. Ai e kupton se përballë sfidave të mëdha globale, përfshirë tensionet mes fuqive botërore, është e domosdoshme që Europa të ruajë një pozicion të pavarur dhe të fortë.

Në këtë mënyrë, Macron ka parashikuar nevojën për të qenë në krye të ndryshimeve që po ndodhin dhe ka bërë të qartë se Franca është e gatshme të luajë një rol të rëndësishëm në një botë gjithnjë e më të polarizuar.

Në mandatin e tyre presidencial, të dy liderët, Macron dhe Trump, kanë paraqitur ide dhe vizione për të ardhmen e Evropës, NATO-s dhe rolit të SHBA-ve në botë. Gjatë periudhës së qeverisjes së tyre, ata kanë pasur qëndrime që dukeshin si kontradiktore, por sot ato mund të shihen si komplementare. Ndoshta sepse lufta e Rusisë në Ukrainë i ka dhënë të drejtë Macronit dhe Trumpit, ose ndoshta ka ardhur koha për rigjenerimin global, me aktorë dhe faktorë të rinj, me aleanca të reja dhe të padëgjuara më parë.

Por një gjë është e sigurt: presidentët e SHBA-së dhe Francës, secili në mënyrën e tij, po tërheqin litarin në dy skajet, duke shkatërruar sistemin post-Luftës së Ftohtë dhe duke formësuar epokën e re globale.

# Ditë të paparashikueshme përpara





Nga Dr. J. Scott YOUNGER

Ka kaluar një muaj që kur Donald Trump hyri për herë të dytë në Shtëpinë e Bardhë. Mund të shtohet vetëm se ka qenë mjaft dramatike, dy luftëra në vazhdim, të cilat ai tha se do t'i ndalonte, dhe nënshkrimi i një numri të madh urdhrash ekzekutivë, duke përfshirë edhe shumë mbështetës të MAGA-s të përfshirë në trazirat e Shtëpisë së Bardhë në janar 2021. Megjithatë, ai gjente ende kohë për të kaluar fundjavat në bazën e tij në Florida dhe për të hyrë në një raund ligjor golfi.

Presidenti e tejkaloi veten kur pontifikoi për luftën në Ukrainë, duke bërë komente në dukje skandaloze për aleatët e tij evropianë dhe në Mbretërinë e Bashkuar dhe duke pasur një gërmim mizor ndaj Presidentit Volodymyr Zelensky, të gjitha të gabuara dhe plot me dezinformata. Dikush dyshon se ai lexon ndonjë gjë dhe "hap gojën dhe lë barkun e tij të gjëmojë" për të cituar një frazë mjaft të zakonshme zhargon. Duhet ta ketë bërë Vladimir Putin të buzëqeshë dhe t'i ketë dhënë atij kënaqësi përpara se bisedimet e paqes të bëhen më serioze. Deri më tani, ai ka gjetur se ka gjetur rrugë për t'u larguar. Gjithmonë ka ardhur në dorë një zgjidhje, për shembull, vetë-shfajësimi si president për disa çështje gjyqësore në pritje për t'iu përgjigjur akuzave për një mori çështjesh, duke përfshirë mashtrimin.

Është 26 shkurt, e mërkurë, dhe Presidenti Emmanuel Macron i Francës ka qenë për të dhënë pikëpamjen evropiane të çështjeve, me luftën në Ukrainë që është në krye të listës, dhe kryeministri britanik do të ndjekë të enjten më 27, veçmas, për të miratuar këndvështrimin evropian dhe, më e rëndësishmja, premton një angazhim nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar për të rritur shpenzimet e mbrojtjes. Emmanuel Macron dhe Keir Starmer nuk kanë bërë asgjë për të ndihmuar, tha Trump më herët! Kjo javë do të jetë interesante për t'u parë pasi Macron dhe Starmer të jenë përballur me Presidentin. Sido që të jetë, evropianët po zgjohen ngadalë me idenë se siguria e tyre në të ardhmen duhet të varet shumë nga ata dhe SHBA-ja nuk mund të mbështetet për ndihmë nëse



nuk shihet se është në interesin e tyre. Amerika e para!! Kjo mund të jetë në dorë.

Trump, i cili e shikon zgjidhjen e çdo problemi si një marrëveshje pronash të paluajtshme që duhet të bëhet, përfitimin e saj, pa marrë parasysh njerëzit që mund të dëmtohen në ekzekutimin e saj, tashmë ka vënë në sy mineralet e vlefshme të tokës së rrallë. Këto mund të gjenden në tokat lindore të Ukrainës dhe do të përdoren për të paguar SHBA-në për mbështetjen e vazhdueshme për luftën, të cilës ai ka thënë se do t'i jepte fund. Kostoja për Perëndimin, të cilën ai e ka vlerësuar gabimisht, e ka marrë shumë në favor të SHBA-së, huatë dhe grantet duke u përzier dhe Evropa ka marrë kashtën e shkurtër. Megjithatë, ai ka të drejtë duke thënë se Evropa është mbështetur shumë në SHBA gjatë viteve. Çështja kryesore e pazgjidhur është se Putini mendon se, si pjesë e çdo marrëveshjeje paqeje, se Rusia do të mbajë të gjitha ose të paktën shumicën e tokave lindore të Ukrainës që Rusia ka pushtuar gabimisht dhe që mban një sasi të mirë të mineraleve të rralla të tokës. Kjo nuk është mënyra që mendon Ukraina, e cila ngjall secila palë për të dhënë diçka, dhe xhaxha Sam për të koordinuar dhe marrë mineralet e rralla të tokës, por duke siguruar që Ukraina të jetë pjesë e Bashkimit Evropian dhe ndoshta NATO-s në vazhdim. Procesi do të zgjasë disa muaj, por luftimet dhe vrasjet, dëmtimet e vazhdueshme të ndërtesave duhet të ndalen përpara përfundimit të marrëveshjes së paqes. Sa më shpejt aq më mirë.

Është një ditë e trishtuar kur Putini do të mendonte, siç la të kuptohet në një fjalim të rrallë të mbajtur pardje, se do të mirëpriste kthimin në rendin e vjetër botëror të procedurave dominuese të SHBA-së, Kinës dhe Rusisë edhe një herë, interpretimin e tij të një zgjerimi të të menduarit të Trump! Unë nuk besoj se kjo është ajo që Trump ka lënë të nënkuptohet nga thëniet e tij ose ajo që dëshiron shumica e botës.

Çështja shqetësuese është se, për shkak se Trump beson se ka një raport të mirë me Putinin, ai tenton të hedhë poshtë disa të pavërteta serioze të këtij të fundit, ose gënjeshtra të drejtpërdrejta, të cilat Putini i nxjerr si linjë zyrtare e Kremlinit, duke pritur që popullata e tij e përgjithshme ta besonte atë dhe vështirësitë që do t'i vinin nëse nuk do ta bënin. Trump duhet të ketë parasysh se mbi gjysmë milioni rusë u larguan nga vendi, përmes kufijve jugorë, kur ai filloi luftën me Ukrainën, ose për të shmangur thirrjen për detyrën e forcave të armatosura ose thjesht për arsye mosmarrëveshjeje me qeverinë. Putinit i është dashur të shkojë në Kinë dhe prej andej në Korenë Veriore, të cilën Trump e vizitoi dy herë herën e fundit që ishte në Shtëpinë e Bardhë, për të marrë trupat shtesë që i nevojiteshin për t'i dhënë vetes ndonjë shans për të marrë një rezultat të kënaqshëm nga lufta.

Trump ka demonstruar një ekip të zgjedhur, i cili duket sikur ka kopjuar disa nga librat e lojërave të Putinit, që është mbledhja në krah të disa prej njerëzve më të pasur në botë, si oligarkët, dhe duke anashkaluar, ku është e mundur, departamentet e qeverisë, duke u dhënë atyre, "oligarkëve", secilit një dorë mjaft të lirë. Kjo ndoshta do të rikthehet tek ai më shpejt se më vonë.

Elon Musk, produkt i një edukimi shumë të pakënaqur dhe të pazakontë dhe me reputacion njeriu më i pasur në botë, është emëruar të drejtojë DOGE (Departamenti i Efikasitetit të Qeverisë) me detyrën për të pastruar departamentet kryesore të qeverisë qendrore dhe për t'i çliruar ato nga çdo korrupsion; ai supozohet të ushtrojë kontroll të njëanshëm mbi të gjithë Qeverinë Federale. Siç thotë gazeta britanike, Byline Times, "Konsolidimi i pakontrolluar i pushtetit i Elon Musk mbi infrastrukturën qeveritare, sistemet financiare, qeverisjen e AI dhe mediat dixhitale nuk i shërben interesave të administratës Trump ose lëvizjes

më të gjerë konservatore —–veprimet e tij tregojnë se ai nuk po punon për Trump ose Partinë Republikane", por më tepër për pushtetin e tij më të afërt – dhe reaksionin e tij. Pjesa tjetër e artikullit është më shqetësuese. Sa do të zgjasë partneriteti Trump-Musk? Muaj? Viti apo dy?

Lufta tjetër që Trump ka deklaruar se do ta ndalonte është ajo në Gaza mes izraelitëve dhe palestinezëve, ose më saktë Hamasit, i cili 'njohur' si organizatë terroriste nga qeveritë perëndimore. Ai ka argëtuar Benjamin Netanyahun, kryeministrin e Izraelit, në Florida, nga i cili, në një konferencë të përbashkët për shtyp, premtoi pastrimin e Rripit të Gazës, për të cilin do t'u kërkonte 2 milionë palestinezëve që jetonin atje të largoheshin dhe të shkonin në Jordani dhe Egjipt, dhe më pas do të ndërtonte "Rivierën e Lindjes së Mesme". Në këtë bombë u hapën gojët!

Ka të paktën dy gjëra që janë të gabuara me atë deklaratë. Së pari, nuk është në dorën e Izraelit t'i japë Gazës; është pjesë e Palestinës. Së dyti, populli i Gazës sigurisht që nuk dëshiron të çrrënjoset nga toka që ka qenë në familjet e tyre për breza, shekuj, megjithëse në masë të madhe është kthyer në rrënoja përmes bombardimeve të vazhdueshme nga izraelitët. As egjiptianët apo jordanezët nuk dëshirojnë të thithin një popullsi kaq të madhe njerëzish të zhvendosur me forcë, të cilët e kanë kaluar vitin e kaluar pa punë, duke u fshehur nga bombardimet e natës nga armët e furnizuara nga SHBA, thjesht duke mbijetuar me ndihmësin e OKB-së, të lejuar me kursim nga Izraeli.



Natyrisht, ekstremistët e djathtë ekstremistë të qeverisë së Netanyahut, të cilët për fat të keq dominojnë procedurat, ishin të kënaqur me njoftimin e Presidentit Trump. Ata vunë në dukje se përndryshe ai do të ishte i okupuar në periudhën e ardhshme me Putinin dhe luftën në Ukrainë dhe përdorën mundësinë për të rritur luftën kundër palestinezëve. Ata kanë marrë ilegalisht një pjesë të mëtejshme të Bregut Perëndimor, Jenin, në pronësi të Palestinës, duke pastruar qytetin nga kryesisht refugjatët për të siguruar hapësirë për ushtarët e tyre. Ata po gjejnë gjithashtu justifikime për të thyer procesin e armëpushimit dhe shkëmbimin e pengjeve, faza e parë që përfundon së shpejti; ushtria po përgatitet edhe një herë për të vazhduar operacionet e saj në Gaza. Çfarë veprimi do të marrë administrata Trump?

Është e drejtë të thuhet se një numër i madh izraelitësh janë të ngopur me grindjet dhe duan të shohin një fund të luftës, e cila me të drejtë ata e shohin se po ndiqet për arsye personale. Zëri i tyre, për fat të keq, nuk ka peshë të mjaftueshme, siç gjendet shpesh në rrethana të ngjashme anembanë botës, me një qeveri që mban një kontroll të fortë mbi pushtetin dhe jo domosdoshmërisht duke përmbushur dëshirat e njerëzve.

Ky proces përmbledhës i ngjarjeve të fundit është nënvizuar nga kalimi në presidencën amerikane, me ardhjen e presidentit të 47-të që mban këtë detyrë prestigjioze, Donald Trump, me gjithë paparashikueshmërinë që ai sjell. Ajo mund të shihet vetëm si një deklaratë në kohë. Do të ishte një burrë i guximshëm që do të parashikonte se çfarë do të ndodhte brenda një jave, nuk ka rëndësi disa muaj. Pra, shikoni këtë hapësirë! **/IFIMES**

# Mosmarrëveshje transatlantike në Ballkan?

*Vizita e Sekretarit të Pëgjithshëm të NATO-s Mark Rutte në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë me ngarkesën e tensioneve të shtuara ndërmjet SHBA dhe Europës*



Nga Frauke SEEBASS*



Edhe ish-sekretari përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, paralajmëronte herë pas here për rrezikun e konflikteve të ngrira në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë. Tani pasardhësi i tij, Mark Rutte, viziton për herë të parë të dy vendet që nga marrja e detyrës në tetor 2024. Më 10 mars 2025 ai viziton fillimisht në kryeqytetin boshnjak Sarajevë dhe një ditë më vonë kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën.

Vizita zhvillohet në atmosferën e një mosmarrëveshjeje transatlantike, që e vendos rendin evropian të sigurisë para sfidave të panjohura – edhe në Ballkanin Perëndimor, transformimi i të cilit dhe integrimi i papërfunduar në BE e bëjnë atë një pikë të lëndueshme të kontinentit.

Në Kosovë forca e NATO-s KFOR siguron paqen dhe kufijtë që nga përfundimi i luftës në 1999. Edhe në Bosnje-Hercegovinë që nga Traktati i Paqes së Dejtonit në 1995 vepron një forcë paqeruajtëse ndërkombëtare, e cila udhëhiqet nga BE që nga viti 2004. Më shumë se 20 vjet pas përfundimit të luftës nuk ka asnjë shenjë të tërheqjes së ushtarëve evropianë, përkundrazi. Që nga fillimi i agresionit rus kundër Ukrainës, rajoni gjendet përsëri në qendër të vëmendjes, për më tepër pasi situata e tensionuar e sigurisë është përkeqësuar prej ndryshimeve globale gjeopolitike vitet e fundit.

## Situata e sigurisë e tensionuar

Që nga Dejtoni, Bosnja dhe Hercegovinaështë ndarë në dy entitete, që gëzojnë autonomi të gjerë, por qeverisin së bashku në nivel federal: Federata, në të cilën jetojnë kryesisht boshnjakët myslimanë dhe kroatët e Bosnjës, dhe Republika Srpska, me një popullsi me shumicë etnike serbe. Kjo e fundit, nën presidentin e saj Milorad Dodik, i cili prej vitesh ndjek një politikë militante nacionaliste, përpiqet të shkëputet nga shteti i Bosnjës, veprim ky që kritikohet ashpër ndërkombëtarisht.

Dodik është nën sanksionet e SHBA. Ai u dënua në shkurt nga një gjykatë boshnjake në instancën e parë me burg dhe me gjashtë vjet ndalim të mbajtjes së posteve politike. Por ai nuk e njeh vendimin dhe mbështetet nga presidenti serb Aleksandar Vuçiç dhe kryeministri hungarez Viktor Orban.

Edhe me Kremlinin Dodiku mban marrëdhënie të mira. Më 9 janar 2025, si çdo vit, në Banja Luka u zhvillua parada e forcave të sigurisë së Republikës Srps-

ka me pjesëmarrjen serbe dhe ruse. Me këtë përkujtohet dita e shpalljes së Republikës Srpska në vitin 1992 – shkëputja e saj paligjshme qe në atë kohë një etapë e rëndësishme në rrugën drejt luftës së Bosnjës. 9 janari u ndalua si ditë përkujtimi nga Gjykata e Lartë e Bosnjës.

### Tensione në Kosovë

Në Kosovë, qeveria në Prishtinë zbaton përdorimin e simboleve dhe institucioneve të njësuara kombëtare që nga viti 2021. Ish-krahina serbe, e banuar kryesisht me shqiptarë etnikë, shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, të cilën kjo nuk e njeh deri më sot. Si pasojë institucionet qendrore publike si arsimi dhe shëndetësia, veçanërisht në veriun me shumicë etnike serbe, vazhduan të drejtoheshin nga Beogradi dhe të përdoreshin dokumentet e tij si dhe dinari serb në vend të monedhës kombëtare, euro.

Kur qeveria aktuale e kryeministrit Albin Kurti filloi t'i jepte fund kësaj praktike, pati në mënyrë të përsëritur revolta dhe bllokada në zonën kufitare, të cilat u mbështetën nga nacionalistët radikalë nga Serbia dhe shteti serb. Në vitin 2022 thuajse të gjithë deputetët serbë të Kosovës dhe nëpunësit civilë në polici dhe gjyqësor dhanë dorëheqje dhe zgjedhjet lokale në provincat veriore u bojkotuan dy herë radhazi. Prandaj në vitin 2023 BE vendosi masa politike dhe ekonomike kundër qeverisë Kurti.

Në shtator 2023 pranë manastirit Banjska në veri të Kosovës ndodhi një sulm terrorist nga militantë serbë nga Kosova dhe Serbia, gjatë të cilit u vranë një polic kosovar dhe tre nga sulmuesit. Si rezultat prania e forcave kosovare të sigurisë në veri u rrit masivisht dhe u vendosën postblloqe, importi i mallrave serbe u ndërpre. Si pasojë e këtyre zhvillimeve marrëdhëniet ndëretnike janë përkeqësuar. Vuçiç dhe Kurti fajësojnë njëri-tjetrin, ndërsa bllokojnë dialogun mes dy vendeve, të udhëhequr nga BE.

### Frika për garancitë amerikane të sigurisë

Përveç këtyre tensioneve Brukseli i frikësohet rrezikut të tërheqjes të SHBA nga Evropa, duke përfshirë kontigjentin e saj prej rreth 600 trupash në KFOR. Edhe pse shtetet evropiane që nga luftërat e Jugosllavisë luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në stabilitetin rajonal, ato kanë qenë gjithmonë të varura nga mbështetja e Shteteve të Bashkuara. Edhe pse vetë Rutte thotë se nuk sheh arsye për t'u shqetësuar për një tërheqje të shpejtë të trupave, ky skenar nuk mund të përjashtohet, duke pasur parasysh retorikën gjithnjë e më të përshkallëzuar të administratës së re amerikane nën presidentin Donald Trump. Përveç kësaj nacionalistët vendas si Dodik ndjehen të inkurajuar nga stili i udhëheqjes së Trump dhe shpresojnë për mbështetje.

Kështu administrata e parë e Trump mbështeti në vitin 2018 planet për një shkëmbim toke mes Kosovës dhe Serbisë. Plani ishte shkëmbimi i zonave të banuara me shumicë serbe në Kosovë me zonat e banuara kryesisht nga shqiptarët në Serbi. Zyrtarë të qeverisë amerikane dhe të besuar të Trumpit, si i dërguari i posaçëm Richard Grenell, kundërshtojnë Kurtin dhe kërkojnë lirimin e ish-presidentit Hashim Thaçi, që u padit në Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë nga vetë prokurori, i cili më vonë shërbeu në SHBA si hetues special për çështjet kundër vetë Trumpit. Zëvendës zëdhënësja e shtypit e Pentagonit, Kingsley Wilson, shkroi së fundmi në X: "Make Kosovo Serbia again".

Ndërsa fokusi i NATO-s në të dy vendet është kryesisht te konfliktet, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova janë njëkohësisht qëndrore për arkitekturën e ardhshme evropiane të sigurisë dhe NATO-n. Prandaj në të dy shtetet misionet ndërkombëtare janë përgjegjëse për trajnimin e forcave vendore të sigurisë. Të dy vendet kanë misione diplomatike në NATO në Bruksel dhe synojnë t'i bashkohen aleancës ushtarake.

Megjithatë Kosova, popullsia e së cilës në masë dërrmuese e mbështet këtë synim, nuk njihet si e pavarur nga katër shtete anëtare të NATO-s. Në Bosnje dhe Hercegovinë bllokon qeveria e Republikës Srpska, e cila refuzon anëtarësimin në NATO. E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për qeverinë pro-ruse në Serbi, ndërsa shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë ndërkohë anëtarë të NATO-s. Vizita e Rutte është një sinjal i qartë se NATO i mban sytë nga ky rajon dhe se stabiliteti i tij ka prioritet të lartë për Evropën dhe partnerët e saj. **/DW**

**Frauke Seebass është studiuese e ftuar në Fondacionin Shkenca dhe Politika (SWP) në Bruksel dhe punon në politikën e zgjerimit të BE me fokus në Ballkanin Perëndimor. Ajo është studente doktorature dhe Carl-Lutz-fellow në Universitetin Andrássy të Budapestit dhe bashkëpunëtore në Shoqatën Gjermane për Politikën e Jashtme (DGAP) Berlin.*

# EUROPA RIARMATOSET!
## Gjermania bën epokë! Hallvë e ftohtë! Komisionerja Kos kërkon reforma!

REAL POLITIK NR. 104 | 1 – 16 MARS 2025 | EKSKLUZIVISHT PËR ARGUMENTUM

**Komente " flash" mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur**

DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*




## 1.

***Europa riarmatoset!*** Kjo ushpall nëSamitin e jashtëzakonshëm të BE-së në Bruksel më 6 Mars. Lajmi i madh ishte miratimi i propozimit të Komisionit Europian për krijimin e fondit kolosal prej 800 miliard Euro për riarmatosjen e Europës përballë kërcënimit rus dhe krisjes me Aleancën me SHBA-në; ndonëse demarshet për ta mbajtur gjallë Aleancën më të madhe të vlerave, parimeve dhe interesave të përbashkëta vijojnë, Europa po përgatitet që shumë shpejt të jetë në gjendje ta mbrojë vetë vehten. Me logon e famshme " Nëse do paqe, përgatitu për luftë"!

Fondi shoqërohet me masa të tjera ekonomike, heqjen e kufizimeve buxhetore për mbrojtjen, etj. Ndërkohë, BE-ja është në kërkim të aleancave të reja për t'i dalë zot vehtes dhe aleatëve të saj. Është gati Londra, me shumë gjasa dhe Ankaraja, dy vendet me ushtritë më të fuqishme mbas SHBA-ve.

